

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2025

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Drejtuar: OE “FLED” sh.p.k.

NIPT K17621104C

Adresa: Berat, Kozare, Havaleas, Lagjja" Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private
1- katëshe, Nr.307.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Nëse po, të jepen dhënat:

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar.

Numri i Procedurës: **REF- 69777-11-20-2025.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Ndërtim i Infrastrukturës Bazës Ajrore Kuçovë”.**

Fondi Limit: **10,985,012.18** (dhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dymbëdhjetë pikë
tetëmbëdhjetë) lek pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 9 (nëntë) jave.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 21.11.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike Nr.73 date 25.11.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “RSM COMPANY”

810802422

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **7,718,342** (Shtatë milionë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e dyzet e dy) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. OE “BONUS Sh.p.k ”

K72412009E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **7,962,183.52** (Shtatë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre presje pesëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. OE “FLED ”

K17621104C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **8,168,702** (Tetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dy) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. OE “HTM”

K97006004D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Vlera: **8,991,717.62** (Tetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

5. **BOE “T&J Construction”**

M29718101T

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

&

SPART-FRANC

L62612207G

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Vlera: **8,962,898** (Tetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

6. **OE “ASI INVEST”**

M01927023H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Vlera: **9,217,353** (Nëntë milionë e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

7. **BOE “3 EL KONSTRUKSION”**

M03002001N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

&

“BESTA “

J62903182B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Vlera: **9,311,951.63** (Nëntë milionë e treqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një presje gjashtëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

8. BOE “M U R A T I”

J66702413V

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

&

“RADIKA”

J77304705D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Vlera: **9,325,020** (Nëntë milionë e treqind e njëzet e pesë mijë e njëzet) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

9. OE “RRODHE - CONSTRUCTION SHPK”

L43123001J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Vlera: **9,335,827.52** (Nëntë milionë e treqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzet e shtatë presje pesëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

10. OE “BAHAS”

J61827083D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Vlera: **9,706,330.09** (Nëntë milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë presje zero nëntë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

11. OE “2 N”

L31615017L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Vlera: **9,800,000** (Nëntë milionë e tetëqind mijë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “RSM COMPANY”

810802422

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsytet si më poshtë:

1. Operatori ekonomik B.O.E “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, nuk ka ofertuar në përputhje me Seksioni I: “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, “Hartimi i ofertës” pika 4. përcaktohet se: “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”.

Në preventivin pa çmime pjesë e dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Objekti: Ndërtim i infrastrukturës Bazës Ajrore Kucovë (Hangari dhe Mjedise Shërbimi)

PREVENTIV PERMBLEDHES PUNIMESH

NR.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1. ANALIZA					
1	PUNIME ELEKTRIKE	Lekë	1		
2	PUNIME HIDROTEKNIKE	Lekë	1		
	SHUMA 1:				
2. PAJISJE					
3	PAJISJE ELEKTRIKE	Lekë	1		
	SHUMA 2:				
Shuma Analiza (Shuma 1)					
Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma TVSH (20%)					
Shuma me TVSH					
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) (Shuma 2)					
Shuma TVSH (për pajisje)					
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)					
Totali pa TVSH					
Totali me TVSH					

Në rastin konkret, nga verifikimi i ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij nuk është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit pasi nga ana e operatorit ekonomik zëri “Shuma TVSH (per pajisjet) nuk eshte plotesuar:

Objekti: “Ndërtim i Infrastrukturës Bazës Ajrore Kuçovë.”

PREVENTIV PERMBLEDHES PUNIMESH

NR.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1. ANALIZA					
1	PUNIME ELEKTRIKE	Lekë	1	4,459,790	4,459,790
2	PUNIME HIDROTEKNIKE	Lekë	1	795,774	795,774
	SHUMA 1:				5,255,564
2. PAJISJE					
3	PAJISJE ELEKTRIKE	Lekë	1	2,200,000	2,200,000
	SHUMA 2:				2,200,000
Shuma Analiza (Shuma 1)					
Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma TVSH (20%)					
Shuma me TVSH					
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) (Shuma 2)					
Shuma TVSH (për pajisje)					
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)					
Totali pa TVSH					
Totali me TVSH					

Referuar dokumentet e tenderit, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës” pika 6. përcaktohet se:

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.
2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasitë dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).

Kur autoriteti/enti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv por ka vetëm një projektide apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron, kontraktori paraqet vetëm ofertë ekonomike totale, në pamundësi për të paraqitur zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të apo çmimet e tyre.

3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

Gjithashtu bazuar në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3/c të VKM -së, Nr. 285 e ndryshuar e cila përcakton: ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur: *shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar*, për sa më lartë oferta e B.O.E “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, refuzohet për arsye se:

Objekti: “Ndërtim i Infrastrukturës Bazës Ajrore Kuçovë.”
PREVENTIV PERMBLEDHES PUNIMESH

NR.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1. ANALIZA					
1	PUNIME ELEKTRIKE	Lekë	1	4,459,790	4,459,790
2	PUNIME HIDROTEKNIKE	Lekë	1	795,774	795,774
	SHUMA 1:				5,255,564
2. PAJISJE					
3	PAJISJE ELEKTRIKE	Lekë	1	2,200,000	2,200,000
	SHUMA 2:				2,200,000
Shuma Analiza (Shuma 1)					5,255,564
Fondi Rezervë (5.0%)					262,778.18
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)					5,518,342
Shuma TVSH (20%)					1,103,668
Shuma me TVSH					6,622,010
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) (Shuma 2)					2,200,000
Shuma TVSH (për pajisje)					-
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)					2,200,000
Totali pa TVSH					7,718,342
Totali me TVSH					8,822,010

Operatori ka ofertuar për zerin në preventivin përmbledhës Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) (Shuma 2) vlerën 2,200,000 leke, ndërkohë nuk ka ofertuar për zerin në preventive Shuma TVSH (për pajisje) vlerën 0 leke. Në fakt vlera për këtë ze duhej të ishte $2,200,000 \text{ leke} \times 20\% = 440,000 \text{ leke}$.

Nese do te kontrollojme se ky gabim i kalon 2% te lejuar me ligj, del se: $7,718,342 \text{ leke pa Tvsh} \times 2\% = 154,366.84 \text{ leke}$.

Pra, vlere e korrigjuar 440,000 leke eshte me e madhe se vlere 2% ose se 154,366.84 leke pra, *shuma absolute te te gjitha korrigjimeve jane me shume se 2% e vleres se ofertës ekonomike te ofruar.*

Në këto kushte, KVO gjykon, se mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim dhe refuzimin e ofertës të B.O.E “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U & “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422.

2. B.O.E “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 1, shkronjen b), pasi Sigurimi i Ofertes nuk eshte paraqitur ne emer te bashkimit te operatoreve ekonomik (BOE) “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma). Ne nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” te VKM Nr.285, pika 2 percaktohet se: *“Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.”* Pra, operatorët kane paraqitur oferten ne emer te BOE por sigurimin e ofertes nuk e kane paraqitur ne emer te BOE, kjo ne shkelje te dispozites ligjore te permendur me siper dhe per kete arsye BOE skualifikohet.

3. Ne Shtojca 1. “FORMULARI I OFERTËS” e dorëzuar ne SPE nga B.O.E “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, skualifikohet për shkak të gabimit aritmetik që tejkalon kufirin ligjor të lejuar prej 2%. Rezulton se cmimi total i ofertës pa TVSH eshte ofertuar 7,718,342 Lekë, nderkohe cmimi total i ofertës me TVSH (20%) i deklaruar nga ofertuesi ne formular eshte 8,822,010 Lekë. Theksojme se cmimi total korrekt me TVSH (20%) duhet te jete: $7,718,342 \times 1.20 = 9,262,010 \text{ Lekë}$
Pra. Kemi te bejme me gabim absolut: $9,262,010 - 8,822,010 = 440,000 \text{ Lekë}$. Theksojme se 2% e vlerës së ofertës pa TVSH: $0.02 \times 7,718,342 = 154,367 \text{ Lekë}$

Sipas nenit 82, pika 3/c të VKM Nr. 285, datë 21.03.2020, ofertat refuzohen kur shumat absolute të korrigjimeve kalojnë 2% të vlerës së ofertës ekonomike. Në rastin konkret, 440,000 eshte me e madhe > se 154,367, prandaj gabimi tejkalon kufirin e lejuar.

Si përfundim, oferta e B.O.E “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, skualifikohet për shkak të gabimit aritmetik që tejkalon 2% të vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

4. Oferta e dorëzuar nga operatori ekonomik B.O.E “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, skualifikohet për shkak të mosplotësimit të kriterit të veçantë të kualifikimit, sipas pikës 2.3.4 të dokumentacionit të tenderit.
Kriteri kërkon: minimum 15 punonjës të punësuar, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e muajit të fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave (Tetor 2025), të vërtetuar nga:
a) Vërtetim i Administratës Tatimore për muajin e fundit të deklaruar, dhe b) Listpagesat e punonjësve, sipas formatit ligjor.

Në formularin e vetëdeklarimit (Shtojca 8 të DST), operatori ka deklaruar 55 punonjës për tre muajt e fundit, por nuk ka specifikuar numrin e punonjësve për muajin Tetor 2025, i cili përkon me periudhën për të cilën kërkohet vërtetimi (afati për dorëzim deri më 20.11.2025 të muajit pasardhës).

Kjo përbën devijim nga kriteri i kualifikimit, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton përmbushjen e kërkesës për muajin Tetor 2025. Sipas rregullave të tenderit, mosplotësimi i një kriteri të veçantë të kualifikimit bën ofertën të pavlefshme. Si përfundim, oferta e operatorit skualifikohet për shkak të mosplotësimit të kriterit të veçantë të kualifikimit për numrin minimal të punonjësve në muajin e fundit të deklaruar.

5. Nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 2.3.8 pasi:

Se pari, certifikatat ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001:2018 janë lëshuar në emër dhe për merite të “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nipt: 810802422 me adresë: Cagllavic, Prishtinë, Kosovë, ndërsa shoqëria pjesëmarrëse në tender “R/S|M CONSTRUCTION” d.sh.h, me Nipt: L04803001U, Njesia Nr.8, Rruga Xhorxhi Martini, Nr. 20, Godine Nr. 11 - kateshe, Shkalla 2, Kati 7, Tiranë, nuk ka paraqitur asnjë nga ISO të kërkuar. Certifikatat ISO jepen për shkak të kushteve që përmbush secila shoqëri dhe nuk mund të transferohet te një shoqëri tjetër. Certifikatat ISO janë certifikata të sistemit të menaxhimit, të cilat jepen për një subjekt të caktuar juridik (NIPT, adresë, staf, procese), pas verifikimit dhe auditimit nga një trup certifikues dhe ato vëjnë vetëm për strukturën, proceset dhe kapacitetet e atij subjekti.

Kjo do të thotë se ISO nuk është pasuri që transferohet dhe rrjedhimisht nuk mund të përdoret nga një subjekt tjetër, qoftë edhe shoqëri “bijë”, “mëmë”, apo pjesë e grupit. ISO-t e lëshuara në emër të shoqërisë mëmë “RSM COMPANY” sh.p.k nuk konsiderohen automatikisht të vlefshme për “R/S|M CONSTRUCTION” d.sh.h, me Nipt: L04803001U, përveç nëse në ISO përcaktohet shprehimisht që vëjnë edhe për të gjitha filialet apo shoqëritë ku subjekti huaj është ortak.

Se dyti, objekti i certifikatave ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001:2018 nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit “Ndërtim Objekteve” por ka për objekt “Projektim, Ndërtim dhe Mirembajtje e Rrugeve, Prodhim i Sinjalistikës Vertikale Rrugore, Instalim i Shenjave Rrugore Vertikale dhe Horizontale, Pengesat e Sigurisë dhe Sistemet e Semaforeve, Ndërtim i Kuadrukeve dhe Rrjetave të Kanalizimeve”. Për 100% të orientuara drejt sektorit rrugor dhe infrastrukturor, jo drejt ndërtimit të objekteve (pra ndërtesave, strukturave civile vertikale, etj.). Kjo do të thotë se operatori nuk ka sistem cilësie të certifikuar për llojin e punimeve që kërkon tenderi.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 30.7.2021 “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit” përcaktohet se: FJALORI I PËRBASHKËT I PROKURIMIT LISTA E KODEVE CPV Shpjegime dhe përshkrime: Fjalori i Përbashkët i Prokurimit është i bazuar në një strukturë bazë, që përfshin kode deri në nëntë shifra, të shoqëruara me një formulim që përshkruan mallrat, punët ose shërbimet, të cilat janë objekt i një procedure prokurimi. Në çdo rast, për zhvillimin e një procedure prokurimi, autoritetet ose entet kontraktore duhet të përzgjedhin detyrimisht në sistemin e prokurimit elektronik një prej kodeve të përcaktuara që i korrespondon objektit konkret të prokurimit. Kodi numerik përbëhet nga 9 shifra, të ndara si më poshtë: - dy shifrat e para identifikojnë ndarjet (XX000000-Y); - tri shifrat e para identifikojnë grupet (XXX00000-Y); - katër shifrat e para identifikojnë klasat (XXXX0000-Y); - pesë shifrat e para identifikojnë kategoritë (XXXXX000-Y). Secila prej tri shifrave të fundit ofron një shkallë më të madhe saktësie brenda secilës kategori. Shifra e nëntë shërben për të verifikuar shifrat e mëparshme KODI CPV EMËRTIMI I KODIT CPV

- Punime ndërtimi për tubacione, linja komunikimi dhe energjie, për autostrada, rrugë 45230000-8
- Punime ndërtimi 45210000-2

Në rastin konkret, referuar dosjes së tenderit, në Formularin e Njoftimit të Kontrates është percaktuar: “**5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Punime ndërtimi, 45210000-2.**”

Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në seksionin “Të tjera”, në rubrikën “Kodet CPV” përcaktohen grupi i kodeve, emërtimi i kodit CPV dhe Identifikimi i kodit CPV për procedurat e prokurimit elektronik.

Sa më sipër, kodi Punime ndërtimi për tubacione, linja komunikimi dhe energjie, për autostrada, **rrugë 45230000-8** që kanë për objekt certifikatat ISO të paraqitura në SPE nga OE, nuk përputhet me kodin CPV të procedurës së prokurimit dhe me objektin e veprimtarisë për të cilën është lëshuar certifikata EN-ISO ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001:2018 për operatorin ekonomik B.O.E “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, pasi objekti i veprimtarisë së certifikatës të sipërcituara ndër të tjera përfshin dhe tregtimin e produkteve industriale.

Për këtë arsye, kriteri i veçantë i kualifikimit nuk mund të konsiderohet i përmbushur.

6. B.O.E “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” sh.p.k (mëma) Nr.Biznesi 810802422, nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, piken 2.3.1, pasi nuk ka paraqitur asnjë punë të ngjashme për Elektrike, Hidraulike për asnjë nga kontratat e paraqitura. Operatori ka paraqitur dy kontrata:

- Kontraten Nr.635-22-11435-5-1-1;
- Kontraten REF-93502-04-19-2021;

Nga verifikimi i kontratave të referuara më sipër, rezulton se Kontraten Nr.635-22-11435-5-1-1 ka për objekt: “Lot 7 NDERTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGES NE FSHATIN DUGAIVCC”, rezulton se i përket një kategorie tjetër. KVO konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin ose karakteristika të tjera të përshkruara në DST.

Pra, si përfundim, kjo kontratë nuk mund të konsiderohet aspak kontratë me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit.

Ne raste të ngjashme edhe Komisioni i Prokurimeve Publike si organi më i lartë që merr vendime administrativisht përfundimtare me Vendimin Nr. 775/2024, datë 01.07.2024, ka vendosur që punë të ngjashme për rrugë nuk konsiderohen të ngjashme për Ndërtimin. Konkretisht, në pikën III.2.8 dhe III.2.9. KPP arsyeton se:

“III.2.8. Në lidhje me kontratat si më poshtë: 2-Kontratë me nr. 112/24 prot., datë 02.05.2019, me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Shënmhill”, Bashkia Durrës”, lidhur midis operatorit ekonomik “INA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Këshilli i Qarkut Durrës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh; Komisioni konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik. Punimet në ujësjellës dhe kanalizime, ndërtim rrugësh dhe ndërtim/rikonstruksion i godinave civile, janë dy kategori punimesh të ndryshme. Pra, si përfundim, kjo kontratë nuk mund të konsiderohet aspak kontratë me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit. III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimes vërteton nuk se plotëson kriterin 2.3.1/b të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit. Rrjedhimisht pretendimi I operatorit ekonomik ankimes “INA” SHPK nuk qëndron.”

Gjithashtu, nga verifikimi i kontrates “RIKONSTRUKSIONI I MJEDISEVE NE BASHKEPRONESI OSE TE PERBASHKETA NE NDERTESAT PALLAT, TE PREKURA NGA TERMETI I DATES 26.11.2019, NE TERRITORIN E BASHKISE LEZHE. (LOTI II)”, te realizuar si Bashkim Operatorësh Ekonomik midis shoqërisë “RSM & HIDRO COMPANY”, nipt: L04803001U & “DESARET COMPANY” SH.P.K, NIPT: K01816001J, rezulton se asnjë ze i preventivit me zera te punimeve te marre persiper per tu realizuar nga shoqeria “RSM & HIDRO COMPANY”, nipt: L04803001U, nuk ka te realizuar asnjë pune te ngjashme per Eletrike, Hidrualike dhe FV Pajisje sikunder jane kerkuar ne preventivin e publikuar nga autoriteti kontraktor ne SPE.

2. OE “BONUS Sh.p.k ”

K72412009E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsytet si me poshtë:

Operatori ekonomik “BONUS” Sh.p.k nuk përmbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2.3.1, pasi nuk ka paraqitur asnjë pune te ngjashme ne fushen e ndertimeve apo rikonstrukcioneve ne Punime ndërtimi, por ka paraqitur nje kontrate Nr.9450Prot, date 17.10.2022, realizuar si BOE ku ky operator ka marre persiper 70% dhe 30% i ka marre persiper anetari tjeter i bashkimit, me objekt: “Ndertim Rruget (Rr. Shen Gjergji + Rr. Ali Pashe Gucia + Rr. Arberia + Seg.Pingul me Rr Selishte + Rr. Vore)” te cilat i perkasin nje kategorie tjeter. KVO konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik.

Pra, si përfundim, kjo kontrate nuk mund të konsiderohen aspak kontrata me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit.

Ne raste te ngjashme edhe Komisioni i Prokurimeve Publike si organi me i larte qe merr vendime administrativisht perfundimtare me Vendimin Nr. 775/2024, date 01.07.2024, ka vendosur qe pune te ngjashme per rruge nuk konsiderohen te ngjashme per Ndertimin. Konkretisht, ne piken III.2.8 dhe III.2.9. KPP arsyeton se:

“III.2.8. Në lidhje me kontratat si më poshtë: 2-Kontratë me nr. 112/24 prot., datë 02.05.2019, me objekt “Rikonstrukcion i rrugës “Shënmhill”, Bashkia Durrës”, lidhur midis operatorit ekonomik “INA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Këshilli i Qarkut Durrës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh; Komisioni konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik. Punimet në ujësjellës dhe kanalizime, ndërtim rrugësh dhe

ndërtim/rikonstruksion i godinave civile, janë dy kategori punimesh të ndryshme. Pra, si përfundim, këto kontrata nuk mund të konsiderohen aspak kontrata me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit. III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues vërteton nuk se plotëson kriterin 2.3.1/b të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit. Rrjedhimisht pretendimi I operatorit ekonomik ankimues “INA” SHPK nuk qëndron.”

3. BOE “T&J Construction”

M29718101T

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

&

SPART-FRANC

L62612207G

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Për arsytet si me poshtë:

- Operatori ekonomik “SPART-FRANC ” Sh.p.k Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 1, shkronjen a) pasi nuk ka deklaruar adresen apo dokumentin konkret mbi bazen e te ciles/cilit autoriteti mund te beje verifikimin e vetdeklarimeve, ne Pjesen II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ne Formularin e Permbledhes te Vetdeklarimit, per Seksionet perkatese:
 - nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane te vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Permbledhes i Vetedeklarimit duhet te plotesohet ne te gjithë seksionet e saj duke dhene deklaruar adresen apo dokumentin

konkret mbi bazen e te ciles/cilit autoriteti mund te beje verifikimin e vetdeklarimeve dhe mosplotesimi i tij ne te gjithe seksionet perkatese perben kusht skualifikimi". Te njehtin qendrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, date 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, date 17.09.2025. Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.

2. Operatori ekonomik **"Spart – Franc" Sh.p.k** skualifikohet pasi nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit për përvojën e suksesshme. Për kontratën e datës 27.08.2020 me Bashkinë Peqin ("Rikonstruksion i Rrugës Sulejman Bej Peqini"), megjithëse ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes, formularin e vlerësimit, situacionin përfundimtar dhe aktin e kolaudit, **nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim**, dokument i detyrueshëm sipas kriterëve të dosjes së tenderit për të provuar realizimin me sukses të kontratës. Nëse operatori do të kishte pasur paqartësi lidhur me kriterin, ai kishte të drejtë të kërkonte sqarim pranë Autoritetit Kontraktor, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik. Megjithatë, operatori **nuk ka shfrytëzuar këtë të drejtë**, ndaj përgjegjësia për mosplotësimin e kriterit mbetet plotësisht tek ai. Për më tepër, dokumentacioni i paraqitur është vetëm në formë fotokopjeje, pa vërtetim noterial, në kundërshtim me nenin 129 të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" dhe kërkesën e dosjes së tenderit që "të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara". Në këto kushte, operatori nuk plotëson as kërkesën për provimin e përvojës së suksesshme, as kërkesën e formës së dokumentacionit, dhe për rrjedhojë **skualifikohet**.
3. Operatori ekonomik "Spart-Franc" Sh.p.k nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.2 – Kapaciteti ekonomik dhe financiar, konkretisht pikën 2.2.1, ku kërkohet paraqitja e vërtetimit të xhiros vjetore për vitet 2022, 2023 dhe 2024, lëshuar nga autoriteti përkatës. Sipas kërkesës së dosjes së tenderit, xhiroja duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, dhe konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik e arrin këtë vlerë të paktën në një nga tre vitet e kërkuara. Operatorit i kërkohej VETËM paraqitja e vërtetimit zyrtar për këto vite, por ai nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për xhiron e viteve 2022, 2023 dhe 2024. Nëse operatori do të kishte pasur paqartësi lidhur me kriterin, ai kishte të drejtë të kërkonte sqarim pranë Autoritetit Kontraktor, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik. Megjithatë, operatori **nuk ka shfrytëzuar këtë të drejtë**, ndaj përgjegjësia për mosplotësimin e kriterit mbetet plotësisht tek ai. Mungesa e xhiros e bën ofertën te pa kualifikueshme dhe, për rrjedhojë, operatori nuk plotëson kushtin e detyrueshëm të kualifikimit dhe skualifikohet.
4. Operatori ekonomik "Spart-Franc" Sh.p.k nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën **2.3.3**, ku kërkohet që operatori të paraqesë **deklaratën për caktimin e Drejtuesit Teknik të punimeve**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të figurojë në listë-pagesat e muajit të fundit nga data e hapjes së ofertave, si dhe të shoqërohet me dokumentacionin përkatës (kontratë pune të vlefshme dhe diplomë). Sipas kriterit, dokumentacioni provues paraqitet nga ofertuesi i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor për sqarime. Operatorit i është kërkuar të paraqesë këtë deklaratë, por **nuk e ka dorëzuar**, duke mos përmbushur kushtin e kërkuar në dosjen e tenderit. Për këtë arsye, operatori **skualifikohet**.
5. Nuk përmbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 1, shkronjen a) pasi nuk ka vetdeklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit Mosangazhimit e Inxhinierit Drejtues Teknik pergjegjes per

Kantierin në Kontrata të Tjera, në Pjesën II: Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, D. Deklaratë, në Formularin e Permblidhjes të Vetdeklarimit, për Seksionin si në vijim:

- Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve. Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, etj., i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Shoqëria “T&J CONSTRUCTION” Sh.p.k, NIPT: M29718101T

6. Operatori ekonomik “T&J CONSTRUCTION” Sh.p.k, nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, pikën 1, shkronjen a) pasi nuk ka vetdekluar në Formularin Permblidhjes të Vetdeklarimit Mosangazhimin e Inxhinierit Drejtues Teknik përgjegjës për Kantierin në Kontrata të Tjera, në Pjesën II: Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, D. Deklaratë, në Formularin e Permblidhjes të Vetdeklarimit, për Seksionin si në vijim:
 - Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve. Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, etj., i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.
7. Operatori ekonomik “T&J CONSTRUCTION” Sh.p.k, nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, pikën 2.3.8 pasi certifikatat ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe ISO 45001:2018 nuk janë paraqitur nga ky operator por vetëm nga anetari tjetër i BOE “SPART-FRANC” Sh.p.k. Certifikatat ISO jepen për shkak të kushteve që përmbush secila shoqëri dhe nuk mund të transferohet te një shoqëri tjetër. Certifikatat ISO janë certifikata të sistemit të menaxhimit, të cilat jepen për një subjekt të caktuar juridik (NIPT, adresë, staf, procese), pas verifikimit dhe auditimit nga një trup certifikues dhe ato vlejnë vetëm për strukturën, proceset dhe kapacitetet e atij subjekti. Kjo do të thotë se ISO nuk është pasuri që transferohet dhe rrjedhimisht nuk mund të përdoret nga një subjekt tjetër, qoftë edhe shoqërise pjesë e bashkimit të operatoreve ekonomik.
8. Operatori ekonomik “T&J CONSTRUCTION” Sh.p.k nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën 2.3.3, ku kërkohet që operatori të paraqesë **deklaratën për caktimin e Drejtuesit Teknik të punimeve**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të figurojë në listë-pagesat e muajit të fundit nga data e hapjes së ofertave, si dhe të shoqërohet me dokumentacionin përkatës (kontratë pune të vlefshme dhe diplomë). Sipas kriterit, dokumentacioni provues paraqitet nga ofertuesi i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor për sqarime. Operatorit i është kërkuar të

paraqesë këtë deklaratë, por **nuk e ka dorëzuar**, duke mos përmbushur kushtin e kërkuar në dosjen e tenderit. Për këtë arsye, operatori **skualifikohet**.

9. Operatori ekonomik “T&J CONSTRUCTION” sh.p.k nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 2.3.9, pasi pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “T&J CONSTRUCTION” sh.p.k & “SPART-FRANC” sh.p.k, rezulton se operatori kryesor “T&J CONSTRUCTION” sh.p.k, i cili ka marrë përsipër në kontratën 25.11.2025 të bashkepunimit 87.92% të vlerës së kontratës, nuk përmbush kriterin e posaçëm të kualifikimit për mjetet dhe pajisjet teknike të kërkuara në Shtojcën 8.

Nga dokumentet e dorëzuara, “T&J CONSTRUCTION” ka deklaruar vetëm:

- një depozitë uji, dhe
- një elektrobetoniere.

Pra, vetëm 2 nga 6 mjetet/pajisjet e kërkuara, ose 33.33% të kapacitetit teknik minimal të parashikuar në DST.

Ky kapacitet është shumë më i ulët se detyrimi i marrë përsipër prej 87.92% të punimeve dhe bie ndesh me kërkesën ligjore të nenit 88, pika 3 të VKM nr. 285/2021, ku përcaktohet se secili anëtar i bashkimit duhet të përmbushë kriteret e kualifikimit në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë.

Mospërputhja e theksuar ndërmjet pjesës së punës (87.92%) dhe kapacitetit teknik të deklaruar (33.33%) e bën objektivist të pamundur që operatori të realizojë pjesën e tij të kontratës dhe për rrjedhojë kriteri teknik nuk plotësohet.

Në bazë të Shtojcës 8 të Dokumenteve të Tenderit, Nenit 88/3 i VKM nr. 285/2021 dhe parimit të proporcionalitetit teknik në bashkimin e operatoreve ekonomik, Operatori ekonomik “T&J CONSTRUCTION” sh.p.k **SKUALIFIKOHET** për mosplotësim të kriterit të posaçëm të kualifikimit.

4. OE “ASI INVEST”

M01927023H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsyet si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “ASI INVEST” Sh.p.k, nuk ka ofertuar në përputhje me Seksioni I: “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, “Hartimi i ofertës” pika 4. përcaktohet se: “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”.

Në preventivin pa çmime pjesë e dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Objekti: Ndërtim i infrastrukturës Bazës Ajrore Kucovë (Hangari dhe Mjedise Shërbimi)

PREVENTIV PERMBLEDHES PUNIMESH

NR.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1. ANALIZA					
1	PUNIME ELEKTRIKE	Lekë	1		
2	PUNIME HIDROTEKNIKE	Lekë	1		
	SHUMA 1:				
2. PAJISJE					
3	PAJISJE ELEKTRIKE	Lekë	1		
	SHUMA 2:				
Shuma Analiza (Shuma 1)					
Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma TVSH (20%)					
Shuma me TVSH					
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) (Shuma 2)					
Shuma TVSH (për pajisje)					
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)					
Totali pa TVSH					
Totali me TVSH					

Në rastin konkret, nga verifikimi i ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij nuk është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit pasi nga ana e operatorit ekonomik zëri “Shuma TVSH (per pajisjet) nuk eshte plotesuar:

PREVENTIVI

Objekti : ““Ndërtim i Infrastrukturës Bazës Ajrore Kuçovë”.

nr	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSI A	SASI A	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1. ANALIZA					
1	PUNIME ELEKTRIKE	Lekë	1		5,321,040
2	PUNIME HIDROTEKNIKE	Lekë	1		1,785,963
	SHUMA 1:				7,107,003
2. PAJISJE					
3	PAJISJE ELEKTRIKE	Lekë	1		1,755,000
	SHUMA 2:				1,755,000
Shuma Analiza (Shuma 1)					
Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma TVSH (20%)					
Shuma me TVSH					
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) (Shuma 2)					
Shuma TVSH (për pajisje)					
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)					
Totali pa TVSH					
Totali me TVSH					

Referuar dokumentet e tenderit, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës” pika 6. përcaktohet se:

3. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.
4. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).

Kur autoriteti/enti kontraktor nuk ka hartuar projekt-preventiv por ka vetëm një projektide apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron, kontraktori paraqet vetëm ofertë ekonomike totale, në pamundësi për të paraqitur zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të apo çmimet e tyre.

5. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
6. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

Gjithashtu bazuar në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3/c të VKM -së, Nr. 285 e ndryshuar e cila përcakton: ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur: *shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar*, për sa më lartë oferta e “ASI INVEST” Sh.p.k, refuzohet për arsye se:

PREVENTIVI

Objekti : ““Ndërtim i Infrastrukturës Bazës Ajrore Kuçovë”.

nr	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSI A	SASI A	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
	1. ANALIZA				
1	PUNIME ELEKTRIKE	Lekë	1		5,321,040
2	PUNIME HIDROTEKNIKE	Lekë	1		1,785,963
	SHUMA 1:				7,107,003
	2. PAJISJE				
3	PAJISJE ELEKTRIKE	Lekë	1		1,755,000
	SHUMA 2:				1,755,000
Shuma Analiza (Shuma 1)					7,107,003
Fondi Rezervë (5.0%)					355,350
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)					7,462,353
Shuma TVSH (20%)					1,492,471
Shuma me TVSH					8,954,824
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) (Shuma 2)					1,755,000
Shuma TVSH (për pajisje)					-
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)					1,755,000
Totali pa TVSH					9,217,353
Totali me TVSH					10,709,824

Operatori ka ofertuar per zerin ne preventivin permbledhes Shuma Pajisje (pa TVSH ne shitje) (Shuma 2) vleren 1,755,000 leke, nderkohe nuk ka ofertuar per zerin ne preventive Shuma TVSH (per pajisje) vleren 0 leke. Ne fakt vlere per kete ze duhej te ishte 1,755,000 leke x 20% = 351,000 leke.

Nese do te kontrollojme se ky gabim i kalon 2% te lejuar me ligj, del se: 9,217,353 leke pa Tvsh x 2% = 184,347.06 leke.

Pra, vlere e korrigjuar 351,000 leke eshte me e madhe se vlere 2% ose se 184,347.06 leke pra, *shuma absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*

Në këto kushte, KVO gjykon, se mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim dhe refuzimin e ofertës të “ASI INVEST” Sh.p.k.

5. BOE “3 EL KONSTRUKSION”

M03002001N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

&

“ BESTA “

J62903182B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsyet si me poshtë:

“3 EL Konstruktion” Sh.p.k, Nipt: M03002001N

1. Operatori ekonomik “3 EL Konstruksion” Sh.p.k nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën **2.3 – Kapaciteti teknik**, konkretisht kërkesën e pikës **2.3.1**, që lidhet me provimin e përvojës së suksesshme në punë të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit. Edhe pse operatori ka paraqitur një kontratë me sektorin privat (“Ndërtim objekti dy katësh për banim”, datë 04.06.2021) së bashku me kontratën e sipërmarrjes, situacionin përfundimtar dhe faturat tatimore, ai **nuk ka paraqitur Aktin e Kolaudimit**, i cili është dokument i detyrueshëm sipas kriterëve të dosjes së tenderit për kontratat e kryera në sektorin privat. Nëse operatori do të kishte pasur paqartësi lidhur me kriterin, ai kishte të drejtë të kërkonte sqarim pranë Autoritetit Kontraktor, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik. Megjithatë, operatori **nuk ka shfrytëzuar këtë të drejtë**, ndaj përgjegjësia për mosplotësimin e kriterit mbetet plotësisht tek ai. Mungesa e këtij dokumenti e bën të pamundur verifikimin e realizimit me sukses të kontratës, sipas kërkesave minimale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Për rrjedhojë, operatori **skualifikohet** për mosplotësim të kriterit të kapacitetit teknik.

“Besta” Sh.p.k, Nipt: J62903182B

1. Operatori ekonomik “Besta” Sh.p.k, nuk përmbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 1, shkronjen a) pasi nuk ka vetdeklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit Mosangazhimin e Inxhinierit Drejtues Teknik pergjegjes per Kantierin në Kontrata te Tjera, ne Pjesen II: Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, D. Deklaratë, ne Formularin e Permbledhes te Vetdeklarimit, per Seksionin si ne vijim:
 - Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruarra në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve. Nëse kërkohet, staf i teknik i poshtëshënuar: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, etj., i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

6. BOE “MURATI”

J66702413V

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

&

“RADIKA”

J77304705D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsyet si me poshtë:

MURATI SHPK ME NIPT J66702413V

1. Operatori ekonomik “MURATI” Sh.p.k, nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën **2.3.5**, ku kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë të punësuar staf inxhinierik, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të vërtetuar me kontratë pune, diplomë, CV dhe listëpagesë për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:
 - 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
 - 1 (një) Inxhinier Elektrik
 - 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

Sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ka deklaruar si staf teknik një Inxhinier Ndërtimi – profili Gjeoteknik, dhe jo një Inxhinier Ndërtimi me profilin e kërkuar në kriter. Profili “Gjeoteknik” nuk është i barasvlefshëm me profilin “Ndërtim”, dhe për rrjedhojë nuk plotëson kërkesën specifike të Autoritetit Kontraktor.

Vlen të theksohet se, referuar ndarjes së punimeve, rezulton se shoqëria “Murati” Sh.p.k ka marrë përsipër kryerjen e një sërë punimesh që kërkojnë detyrimisht prezencën dhe mbikëqyrjen e një Inxhinieri Ndërtimi, si punime konstruktive, beton, armaturë, soleta, muraturë, shtresa nënbaze dhe punime asfaltike. Këto punime nuk mund të mbikëqyren teknikisht nga një inxhinier me profil gjeoteknik, pasi ky profil nuk mbulon kompetencat profesionale të kërkuara për ndërtim civil.

Në këto kushte, dhe duke qenë se operatori nuk ka shfrytëzuar të drejtën për të kërkuar sqarime lidhur me kriterin, përgjegjësia për mosplotësim mbetet tek operatori. Për rrjedhojë, operatori skualifikohet për mosplotësimin e kriterit të kualifikimit sipas pikës 2.3.5.

2. Operatori ekonomik “MURATI SHPK” Sh.p.k nuk permbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 2.3.1, ku kerkohet: *“1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:*

a) *Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);*
- *Kontratë Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Aktin e kolaudimit;*
- *Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.*

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Kontrate Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Aktin e kolaudimit;*
- *Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.*

- 1.1** *Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.,*

Ne permbushje të kriterit të referuar me sipër, operatori ka paraqitur 3 kontrata:

- Kontrata lidhur më 07.03.2024 nënshkruar midis BOE “Murati” Sh.p.k & “LIS KONSTRUKSION” Sh.p.k dhe autoritetit kontraktor Bashkisë Prenjas, me objekt: *“Rikonstruksion i shkolles se mesme "Dalip Tocka "Kotodesh”.*
- Kontrata Nr.1265 Prot. Date 11.03.2021, nënshkruar midis BOE “Murati” Sh.p.k & “EURO-ALB” Sh.p.k dhe autoritetit kontraktor Bashkisë Rrogozhine, me objekt: *“Ndertim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, Lagja e Re Gose, Bashkia Rrogozhine”.*

- Kontrata lidhur më 24.04.2023 nënshkruar midis BOE “Murati” Sh.p.k & “LIS KONSTRUKSION” Sh.p.k dhe autoritetit kontraktor Bashkisë Bulqize, me objekt: *“Ristemim Asfaltim i Rrugës Krajke e Siperme”*.

Se pari, ne lidhje me kontratën lidhur më 07.03.2024 nënshkruar midis BOE “Murati” Sh.p.k & “LIS KONSTRUKSION” Sh.p.k dhe autoritetit kontraktor Bashkisë Prrenjas, me objekt: *“Rikonstruksion i shkollës së mesme “Dalip Tocka “Kotodesh”*, konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur *“Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme”* edhe pse kjo është kërkuar në mënyrë të qartë në kriterin e kualifikimit. Nëse operatori do të kishte pasur paqartësi lidhur me kriterin, ai kishte të drejtë të kërkonte sqarim pranë Autoritetit Kontraktor, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik. Megjithatë, operatori nuk ka shfrytëzuar këtë të drejtë, ndaj përgjegjësia për mosplotësimin e kriterit mbetet plotësisht tek ai.

Se dyti, ne lidhje me kontratën Nr.1265 Prot. Date 11.03.2021, nënshkruar midis BOE “Murati” Sh.p.k & “EURO-ALB” Sh.p.k dhe autoritetit kontraktor Bashkisë Rrogozhine, me objekt: *“Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujerave të zeza, Lagja e Re Gose, Bashkia Rrogozhine”* dhe Kontrata lidhur më 24.04.2023 nënshkruar midis BOE “Murati” Sh.p.k & “LIS KONSTRUKSION” Sh.p.k dhe autoritetit kontraktor Bashkisë Bulqize, me objekt: *“Ristemim Asfaltim i Rrugës Krajke e Siperme”*, KVO konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohen në natyrën, kompleksitetin ose karakteristikën të tjera të përshkruara në DST. Punimet në ndërtim Ujesjellsa, Rruga dhe ndërtim/rikonstruksion i godinave civile, janë tre kategori punimesh të ndryshme. Pra, si përfundim, kjo kontrata nuk mund të konsiderohet aspak kontrata me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit. KVO konstaton gjithashtu se për kontratën date 24.04.2023 operatori ekonomik nuk ka paraqitur *“Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme”* edhe pse kjo është kërkuar në mënyrë të qartë në kriterin e kualifikimit. Nëse operatori do të kishte pasur paqartësi lidhur me kriterin, ai kishte të drejtë të kërkonte sqarim pranë Autoritetit Kontraktor, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik. Megjithatë, operatori nuk ka shfrytëzuar këtë të drejtë, ndaj përgjegjësia për mosplotësimin e kriterit mbetet plotësisht tek ai.

Nga sa me sipër operatori ekonomik Murati“ Sh.p.k skualifikohet.

Ne rastet e ngjashme edhe Komisioni i Prokurimeve Publike si organi me i lartë që merr vendime administrativisht përfundimtare me Vendimin Nr. 775/2024, datë 01.07.2024, ka vendosur që punët e ngjashme për rrugë nuk konsiderohen të ngjashme për Ndërtimin. Konkretisht, në pikën III.2.8 dhe III.2.9. KPP arsyetohet se:

“III.2.8. Në lidhje me kontratat si më poshtë: 2-.Kontratë me nr. 112/24 prot., datë 02.05.2019, me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Shënmhill”, Bashkia Durrës”, lidhur midis operatorit ekonomik “INA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Këshilli i Qarkut Durrës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

1-. Kontratë me nr. 10057/6 prot., datë 19.08.2019 me objekt “Rikonstruksion rrjet ujësjellësi në rrugën “Bedri Karapici”, “Hamdi Pepa””, lidhur midis operatorit ekonomik “INA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë ShA, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

2-.Kontratë me nr. 112/24 prot., datë 02.05.2019, me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Shënmhill”, Bashkia Durrës”, lidhur midis operatorit ekonomik “INA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Këshilli i Qarkut Durrës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

3-Kontratë me nr. 29348/6 prot., datë 24.02.2020, me objekt “Ndërtim dhe Rikonstruksion linjash kanalizimi në Njësitë 1, 2, 3, 4, 5, dhe Drejtorinë Rajonale”, lidhur midis operatorit ekonomik “INA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë ShA, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh; 4- Kontratë me nr. 5252 prot., datë 11.10.2022 me objekt “Rrjeti i brendshëm ujësjellës”, lidhur midis operatorit ekonomik “INA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Maliq, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

Komisioni konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik. **Punimet në ujësjellës dhe kanalizime, ndërtim rrugësh dhe ndërtim/rikonstruksion i godinave civile, janë dy kategori punimesh të ndryshme.** Pra, si përfundim, këto kontrata nuk mund të konsiderohen aspak kontrata me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit. III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumnin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumnin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues vërteton nuk se plotëson kriterin 2.3.1/b të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit. Rrjedhimisht pretendimi I operatorit ekonomik ankimues “INA” SHPK nuk qëndron.”

7. OE “RRODHE - CONSTRUCTION SHPK”

L43123001J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsyet si me poshtë:

1. Operatori ekonomik “Rrodhe Construction” Sh.p.k nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 2.3.1, pasi nuk ka paraqitur asnjë punë të ngjashme në fushën e ndertimeve apo rikonstruksioneve në Punime ndërtimi, por ka paraqitur një kontratë Nr.91Prot, datë 08.01.2024, me objekt: “*NDERTIM I RRUGES PRANE VALA PARK BERAT*” e cila i perket një kategorie tjetër. KVO konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik. Punimet në ndërtim rrugësh dhe ndërtim/rikonstruksion i godinave civile, të cilat janë dy kategori punimesh të ndryshme. Pra, si përfundim, kjo kontratë nuk mund të konsiderohet aspak kontratë me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit.
Ne raste të ngjashme edhe Komisioni i Prokurimeve Publike si organi me i lartë që merr vendime administrativisht përfundimtare me Vendimin Nr. 775/2024, datë 01.07.2024, ka vendosur që punë të

ngjashme per rruge nuk konsiderohen te ngjashme per Ndertimin. Konkretisht, ne piken III.2.8 dhe III.2.9. KPP arsyeton se:

“III.2.8. Në lidhje me kontratat si më poshtë: 2-Kontratë me nr. 112/24 prot., datë 02.05.2019, me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Shënmhill”, Bashkia Durrës”, lidhur midis operatorit ekonomik “INA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Këshilli i Qarkut Durrës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh; Komisioni konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin ose karakteristikat të tjera të përshkruara në raportin teknik. Punimet në ujësjellës dhe kanalizime, ndërtim rrugësh dhe ndërtim/rikonstruksion i godinave civile, janë dy kategori punimesh të ndryshme. Pra, si përfundim, këto kontrata nuk mund të konsiderohen aspak kontrata me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit. III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues vërteton nuk se plotëson kriterin 2.3.1/b të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit. Rrjedhimisht pretendimi I operatorit ekonomik ankimues “INA” SHPK nuk qëndron.”

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, : **OE “FLED” sh.p.k** me NIPT K17621104C me adrese Berat, Kozare, Havaleas, Lagjja" Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **8,168,702** (Tetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

